

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A.

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar me 31 Dhjetor 2024

Prill, 2025

Përmbajtja:

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	3
Deklarata e pajtueshmërisë.....	6
Pasqyrën e pozicionit financiar.....	7
Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	8
Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet	9
Pasqyra e rrjedhës së parasë.....	10
Shënimet mbi pasqyrat financiare	11



“Eco&Conto” sh.p.k.
Kompani Ligjore e Auditimit
Rr. Vllezërit Gërvalla
70000 Ferizaj, Kosovë
Mob. +383 44 418 308
Email: eco_conto@hotmail.com

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Klubit të Futbollit Ferizaj SH.A.

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A.** që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. më 31 Dhjetor 2024, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Po ashtu ne jemi siguruar dhe konfirmojmë se pika G e rregullores së UEFA-s për Licensimin e Klubeve është përmbushur plotësisht, dhe opinionin ynë është në përputhje me këtë pikë

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Theksim i çështjes:

Siq është paraqitur në shënimin numër 6 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera me vlerë (2024: 56,459) (2023: 42,750) Për shkak të natyës së shënimeve të klubit të futbollit, ne nuk ishim në gjendje, që me aplikimin e procedurave standarde dhe alternative të auditimit, të kënaqim veten në lidhje me saktësin e llogarive të arkëtueshme të paraqitura në Pasqyrat Financiare të klubit.

Siq është paraqitur në shënimin numër 4 Paraja dhe ekuivalentët e parasë me vlerë (2024: 84,686) (2023: 132,616) Për shkak të natyës së shënimeve të klubit të futbollit, ne nuk ishim në gjendje, që me aplikimin e procedurave standarde dhe alternative të auditimit, të kënaqim veten në lidhje me saktësin e gjendjes së arkës të paraqitura në Pasqyrat Financiare të klubit.



“Eco&Conto” sh.p.k.
Kompani Ligjore e Auditimit
Rr. Vilezërit Gërvalla
70000 Ferizaj, Kosovë
Mob. +383 44 418 308
Email: eco_conto@hotmail.com

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që sipas gjykimit tonë profesionale ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare në periudhën aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi dhe në formimin e opinionit tonë mbi të dhe Ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vijimësinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Klubin apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare. Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu: * Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.



“Eco&Conto” sh.p.k.
Kompani Ligjore e Auditimit
Rr. Vllezërit Gërvalla
70000 Ferizaj, Kosovë
Mob. +383 44 418 308
Email: eco_conto@hotmail.com

- Konkludojm mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Klubit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personelin e ngarkuar lidhur me çështjet tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative

Ne jemi angazhuar si auditor të Klubit të Futbollit Ferizaj SH.A.

- a) Për perudhën 01.01.2024- 31.12.2024 me datë 02.02.2025 nga aksionarët e Klubit të Futbollit Ferizaj SH.A.
- b) Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t’iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- c) Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në nenin 5 të UA nr. 02/2019 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit.

“Eco&Conto” sh.p.k.



Naser Qenim
01 Prill, 2025
Rr. Vllezërit Gërvalla
70000 Ferizaj, Kosovë

Deklaratë e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare vjetore për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024


Në pajtueshmëri me vendimin e kryetarit të bordit të Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. deklaronë se:

- a) Pasqyrat financiare dhe shënimet e paraqitura në faqet 6-25, janë në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Rregulloret dhe Urdhëresat Administrative të aplikueshme, përfshirë:
- (i) Pajtueshmërinë me Standardet e aplikueshme Ndërkombëtare të Kontabilitetit përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNK-SNRF) dhe
 - (ii) Paraqesin drejt dhe fer Bilancin e Gjendjes, Bilancin e Suksesit, Pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe ndryshimet në ekuitet të Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. me 31 Dhjetor 2024 dhe të performancës së saj për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024.
- b) Sipas opinionit të Drejtorëve ka bazë të arsyeshme të besojmë se Klubi do të jetë në gjendje të paguaj detyrimet e saj në momentin kur maturohen dhe bëhen të pagueshme.


Drejtor menaxhues


z. Betim Isufi

Kryetar I bordit të aksionarëve


z. Lulzim Abazi

Kontabilist I certifikuar


z. Dardan Imeri

Ferizaj
Me 01.04.2025



Pasqyra e Pozicionit Financiar
Periudha 01.01.2024 deri 31.12.2024

Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023
	€	€
PASURITË		
Pasuritë afatshkurtra		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	84,686
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	6	56,459
Pasuritë e tjera afatshkurtra	8	58,700
Gjithsejt pasuritë afatshkurtëra	199,845	234,066
Pasuritë afatgjata		
Pasuritë humane	10	67,800
Prona, pajisjet dhe impiantet	10	71,964
Gjithsejt pasuritë Afatgjata	139,764	121,616
Gjithsej pasuritë	339,608	355,683
DETYRIMET DHE EKUITETI		
DETYRIMET		
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	14	68,304
Detyrimet ndaj kontributeve dhe tatimit në burim	16	31,044
Detyrimet e tjera afatshkurtra	17	6,000
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	105,348	51,148
Detyrimet afatgjata		
Detyrimet e tjera afatgjata	-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata	-	-
Gjithsej detyrimet	105,348	51,148
EKUITETI		
Kapitali aksionar	20	150,000
Fondet e mbajtura	22	84,261
Gjithsej ekuiteti	234,261	304,535
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	339,608	355,683

Të aprovuara të lëshuara nga menaxhmenti dhe të nënshkruara në emër të tij me 01 Prill, 2025.

Drejtor menaxhues
z. Betim Isufi

Kryetar I bordit të aksionarëve
z. Lulzim Abazi

Kontabilist I certifikuar
z. Dardan Imeri

Shënimet shpjeguese nga faqe 11 deri në 25 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Periudha 01.01.2024 deri 31.12.2024

	Shenimi	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024 €	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023 €
Të hyrat	31	548,740	405,726
Kostoja e shitjes		-	-
Fondi Bruto		548,740	405,726
Shpenzimet e shpërndarjes	32	-	(9,639)
Shpenzimet administrative	33	(592,885)	(408,787)
Shpenzimet tjera	34	(25,646)	(26,392)
Fondi operativ		(69,791)	(39,092)
Shpenzimet financiare	35	(483)	(475)
Fondi i vitit		(70,274)	(39,567)
Shpenzimet e tatimit në fitim/humbjet e bartura		-	-
Fondi i vitit	36	(70,274)	(39,567)

Shënimet shpjeguese nga faqe 11 deri në 25 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Periudha 01.01.2024 deri 31.12.2024

	Kapitali I deklaruar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
	€	€	€
Gjendja me 01 Janar 2023	150,000	194,102	344,102
Fondi i vitit	-	(39,567)	(39,567)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2023	150,000	154,535	304,535
Gjendja me 01 Janar 2024	150,000	154,535	304,535
Fondi i vitit	-	(70,274)	(70,274)
Gjendja 31 Dhjetor 2024	150,000	84,261	234,261

Shënimet shpjeguese nga faqe 11 deri në 25 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë

Periudha 01.01.2024 deri 31.12.2024

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024 €	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fondi i vitit	36	(70,274)	(39,567)
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	32	-	9,639
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese-humane		-	(3,000)
Shpenzimet financiare	35	483	475
Shpenzimet e tatimit në fitim		=	=
		(69,791)	(32,453)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative:</i>			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(13,709)	(12,140)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		-	-
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		47,573	20,731
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		6,627	26,714
		<u>40,491</u>	<u>35,306</u>
Tatimi në fitim i paguar			
Interesi i paguar	35	(483)	(475)
		(483)	(475)
Rrjedha neto e parase nga aktivitet operative		<u>(29,783)</u>	<u>2,378</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	10	(18,147)	(6,376)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		<u>(18,147)</u>	<u>(6,376)</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		<u>(47,931)</u>	<u>(3,998)</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		132,616	136,614
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	4	<u>84,686</u>	<u>132,616</u>

Shënimet shpjeguese nga faqe 11 deri në 25 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Emri i biznesit	Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A.
Emri tregtar	Fc Ferizaj
Lloji biznesit	Shoqëri aksionare
Numri unik identifikues	811340687
Numri punëtorëve	32
Data e regjistrimit	13/08/2019
Komuna	Ferizaj
Adresa	Ferizaj, Rruga Brahim Ademi, Pn.
Telefoni	+38349325533
E-mail	fcferizaj1923@gmail.com
Kapitali	150,000.00€
Statusi në ARBK	Regjistruar

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Betim	Isufi	Drejtore menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Fahri Bega	14,700.00 €	9.80 %
Fatmir Reshani	14,700.00 €	9.80 %
Xhevat Rushiti	45,600.00 €	30.40 %
Lulzim Abazi	75,000.00 €	50.00 %

Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi
9312	Aktivitetet e klubeve sportive	Primarë
9311	Funksionimi i objekteve sportive	Sekondarë
9319	Aktivitetet e tjera sportive	Tjera
7721	Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i artikujve rekreativë dhe sportivë	Tjera
8551	Arsimi për sporte dhe rekreacion	Tjera

Numri i të punësuarve më 31 Dhjetor 2024 ishte 31 (31 Dhjetor 2023:33).

2 ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.2 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën pas vitit që mbaron më 31 Dhjetor 2024

Të tjera

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. nuk pret ndonjë standard tjetër të nxjerrë nga BSNK, dhe jo efektiv, që të ketë ndonjë ndikim material në Klub.

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Klubit në periudhën e zbatimit fillestar.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri SNRF dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Kosovës si dhe standardet e kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

3.2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyra financiare është raport financiar për qëllime të përgjithshme i cili përgatitet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë, me Standardet e Kontabilitetit dhe në harmoni me kërkesat e Bordit për Raportime Financiare të Kosovës, si dhe për nevoja të Menaxhmentit dhe shfrytëzuesve tjerë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me kostot historike të pasurive dhe detyrimeve për çka ka dëshmi të mjaftueshme.

4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
4. Paraja në arkë dhe në bankë	EURO	EURO
Arka	84,686	70,724
Totali nga arkat	84,686	70,724
4.1 Paraja në bankë		
Banka ekonomike	34.951,71	61,892
Toali I parasë nga bankat	-	61,892
Gjithsej paraja në arkë dhe bankë	84,686	132,616

4.1 Valuta e këmbimit

Monedha raportuese e Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. është njësia monetare e Unionit European (Euro). Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

5. Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Klubi bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga asetit financiar skadon, ose kur asetit financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

6. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë bartur në shumat e faturuara siç janë reduktuar nga provizioni i bërë për dëmin e tyre. Provizioni për borgjet e këqija mund të vendoset me vendime të vlefshme, kur ka evidencë objektive se Klubi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e pritura.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		
Llogaritë nga vendorët	56,459	42,750
Gjithsej	56,459	42,750

7. Stoqet

Stoqet e Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. Nuk ka stoqe në fundë të vitit 2023. Vlera e stoqeve do të vlerësohet me koston historike, më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare.

8. Pasuritë e tjera dhe të arkëtueshmet

Huat dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Këto janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e bilancit të gjendjes. Kreditë dhe të arkëtueshmet e Klubit në datën e bilancit të gjendjes përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
8. Pasuritë e tjera afatshkurtra		
Kërkesat nga aksionarëve	58,700	58,700
Gjithsej	58,700	58,700

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

9. Asetet humane

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. klasifikon asetet e saj humane në këto kategori si në vijim: Lojtarët profesional, trajnerët profesional, stafin profesional i cili ka aftësin e vlerësimit të lojtarëve dhe edukimin e tyre konform rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare të UEF-ës, etj.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
9. Pasuritë humane		
Lojtarë, trajnerët stafi I klubit	64,800	64,800
Investimi në trajner	3,000	3,000
Gjithsej	67,800	67,800

10. Prona, impiantet dhe paisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe paisjeve që ekzistojnë me 1 Janar 2024 janë bartur sipas kostos së tyre historike, minus zhvlerësimi I akumuluar pasues. E gjithë prona, impiantet dhe paisjet tjera janë paraqitur sipas kostos minus zhvlerësimi I akumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që I atribuohet drejtpërdrejt përvetësimit (blerjes) të zërave. Kostot pasuese janë përfshirë në vlerë bartëse të mjeteve apo është njohur si mjet I vaçant, në mënyr të duhur, vetëm atëher kur përfitimet ekonomike të mundshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Klub dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Zhvlerësimi në pasurinë është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuara të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parshikuar, siç vijon:

Ndërtesat	5%
Kompjuterët	20%
Paisjet e zyrës, veturat	20%

Vlerat e mbetura të pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e nevojshme, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera bartëse e një pasurie është e shënuar menjëher në vlerën e saj të rikuperueshme nëse vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se sa është parashikuar vlera e rikuperueshme. Humbjet ose fitimi janë përcaktuar nga rrjedha e krahasimit me vlerën bartës. Këto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave. Pasqyrat financiare janë të paraqitura në EUR. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me konventën e kostos historike, por nikohësisht e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe paisjeve në shumat e rivlersuara. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe poqese nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar. Pëgaditja e pasqyrave financiare konform të SNRF kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Githashtu këkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.

Periudha raportuese e Shoqërisë përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore pra 01. Janar deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

10.1 Zhvlerësimet e aseteve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shuma bartëse e një aseti nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një aseti e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihen në të ardhura. Vlera e rikuperueshme e një aseti është çmimi më i lart shitës neto i një aseti dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shuma e arritshme nga shitja e një aseti në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë në të ardhmen e flukseve të parasë që pritët të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një aseti dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të holla.. Shkalla e zhvlerësimit të aseteve sipas pëcaktimit të vlerësuesve mbi jetën e përdorimit dallon nga shkalla e zhvlerësimit sipas Rregulloreve në fuqi:

Ndëtesat	20 vite
Paisje-makineria	5 vite
Automjetet	5 vite

10.2 Vlerësimi i pasigurisë

Zhvlerësimi

Kur do që shuma bartëse e një aseti ose një njësi gjeneruese të hollash e tejkalon shumën e rikuperueshme të tij, një humbje nga rënia e vlerë duhet njohur. Kur përcaktohet shuma e rikuperueshme, Menaxhmenti vlerëson pritjet e flukseve të parasë nga secila njësi gjeneruese-të hollash dhe përcakton normën e interesit për llogaritjen e vlerës aktuale të rrjedhjes së parasë.

Jeta e dobishme e aseteve të zhvlerësueshme

Menaxhmenti rishikon jetën e dobishme të aseteve të zhvlerësueshme në çdo datë të raportimit. Më 31 Dhjetor 2024, menaxhmenti vlerëson se jeta e dobishme përfaqëson pritjet e përfitimeve nga asetet për Klubin. Shumat bartëse janë analizuar, megjithatë, mund të ndryshojnë për shkak të vjetërimit teknik.

10. Prona, impiantet dhe paisjet	Ndërtesat	Pajisjet	Mobiljet dhe orenditë	Totali/EURO
KOSTO				
Më 1 Janar 2024	24,494	45,949	2,500	72,943
Sht-rivl gjatë vitit	-	18,147	-	18,147
Më 31 Dhjetor 2024	24,494	64,096	2,500	91,090
ZHVLERËSIMI				
Më 01 Janar 2024	3,061	14,782	1,283	19,126
Zhvlërësimi për vitin	-	-	-	-
Eliminimet në shlyerje	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	3,061	14,782	1,283	19,126
VLERA E BARTUR NETO				
Më 31 Dhjetor 2024	21,432	49,315	1,217	71,964
Më 1 Janar 2024	21,432	31,167	1,217	53,816

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

11. Pasuritë kontingjente

Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet.

12. Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuter. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metoden lineare përderisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjat kohzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

13. Shpenzimet e huazimit

Shpenzimet e huazimit kryesisht përbëhen nga interesi mbi huazimet e Klubit. Të gjitha kostot e huamarrjes, duke përfshirë koston e huamarrjes drejtpërdrejtë i atribuohet përvetësimit, ndërtimit apo prodhimit të një aseti të caktuar, janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë shkaktuar dhe raportuar në kostot financiare.

14. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Këto shuma përfaqësojnë detyrimet e pa paguara për mallrat dhe shërbimet e ofruara ndaj Klubit para fundit të vitit financiar. Përshkak të natyrës së tyre afatshkurtër, ato maten me kosto të amortizuar dhe nuk zbriten.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
14. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		
Furnitor vendor	68,304	20,731
Gjithsej	68,304	20,731

15. Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i Klubit ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

16. Tatimi

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. nuk është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël të kalkuluar në përputhshmëri me rregulloret në fuqi bazuar në Ligjin nr. 05/L-029 Neni 7 të ardhurat e liruara nga tatimi në fitim.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
16. Tatimet e pagueshme aktuale		
Detyrime ndaj kontributeve dhe tatimit në burim	31,044	16,344
Detyrime ndaj ATK-ës me marrveshje	-	5,573
Gjithsej	31,044	21,917

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
17. Detyrimet e tjera afatshkurtra		
Detyrimet ndaj huazimeve	6,000	8,500
Gjithsej	6,000	8,500

17. Provizionet, detyrimet kontingjente dhe asetet kontingjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluar mund të çojë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumatat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara.

Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Aty ku ka një numër të detyrimeve të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohej në shlyerje të obligimit përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve si tërësi. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale.

Të gjitha provizionet rishikohen në çdo datë të raportimit dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

18. Menaxhimi i riskut financiar dhe capital

Menaxhimi financiar i riskut të Klubit bartet nga bordi i drejtorëve.

Objektivat e Klubit kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që Klubi të vazhdojë me punë në të ardhmen.

19. Risku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë Klubit në risk kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë të Klubit përbëhen kryesisht nga salldot bankare.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

20. Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë përbëhet nga vlera monetare e kontribuar, e regjistruar në librat e Klubit në shumën prej **150,000 EUR**.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
20. Kapitali aksionar		
Kapitali fillestarë	150,000	150,000
Gjithsej	150,000	150,000

21. Risku i likuiditetit

Klubi menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vrojtim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepricë apo ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritët të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vrojtim.

Klubi mban të holla për të përmbushur kërkesat e likuiditetit minimum për periudhën 30-ditore. Financimi i nevojave për likuiditet afatgjatë është një siguri shtesë për Klubin.

22. Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionarët e Klubit.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
22. Fitimet e mbajtura		
Fondet e bartura nga vitet e kaluara	154,535	194,102
Fondi i vitit	(70,274)	(39,567)
Gjithsej	84,261	154,535

23. Mjetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë asete financiare të mbajtura për tregti. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kryesisht është përvetësuar për qëllim shitje në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë klasifikuar si asete qarkulluese. Klubi nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori deri në datë të raportimit.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

24. Përfitimet e punëtorëve

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, ka bërë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

25. Njohja e të ardhurave operative

Të ardhurat e Klubit janë kryesisht të hyra të cilat realizohen nga donacionet dhe sponsorizime të ndryshme, dhe njihen në momentin e faturimit, gjegjësisht arkëtimit.

Të ardhurat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhen e transaksioneve të Klubit dhe kur shuma e të hyrave mundë të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të Klubit janë përmbushur. Këto kriteret të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

26. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

27. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të kapitalit

Objektivat e Klubit për menaxhimin e kapitalit janë për të ruajtur aftësinë e Klubit që të vazhdoj aktivitetin mbi parimin e vazhdimësisë në mënyrë që të sigurojë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të zvogëluar koston e kapitalit. Në mënyrë që të ruajë ose të përshtat strukturën e kapitalit, Klubi mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar për aksionarët, kthimi i kapitalit tek aksionarët, të emetoj aksione të reja ose të shesë asete për të reduktuar borxhin.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

28. Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e aseteve financiare, të tilla si letra me vlerë në dispozicion për shitje që tregtohen në tregjet aktive është e bazuar në çmimet e kuotuar të tregut, të cilat janë çmimet e tanishme të ofertës. Vlera e drejtë të aseteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv përcaktohet duke përdorur supozimet në bazë të kushteve të tregut ekzistues në çdo datë të bilancit të gjendjes. Vlera nominale minus përshtatjet e vlerësuara të kreditit e të arkëtueshmeve tregtare dhe detyrimeve janë supozuar te vlera e drejtë përafërt e tyre.

29. Instrumentet financiare sipas kategorive

Vlerat bartëse të aseteve dhe detyrimeve financiare të Klubit të njohura në datën e bilancit të gjendjes të periudhës së raportuese nën vështrim.

30. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE TË KONTABILITETIT

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të Klubit, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2, menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime lidhur me shumën bartëse të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë paraqitur nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet janë shqyrtuar në një bazë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve të kontabilitetit njihet në periudhën në të cilën vlerësim është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën e tanishme dhe në të ardhmen.

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
31. Të hyrat	EURO	EURO
Te hyrat gjatë shkollës së futbollit	-	2,000
Te hyra nga sponzorizimet	538,507	278,950
Te hyrat nga Federata	10,000	119,694
Te hyrat nga donacionet	233	500
Te hyrat nga primi Sigal	-	4,582
Gjithsej	548,740	405,726

	Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
	EURO	EURO
32. Shpenzimet administrative		
Shpenzimet Administrative,Reklama etj.		
Shpenzimet e Materialit Zyre	721	613
Shpenzimet e Internetit	385	330
Shpenzimet juridike	1,975	858
Shpenzimet e autobusit	205	
Shpenzimet e pagave	392,337	310,257
Shpenzimet per Veshje etj.	18,153	2,059
Shpenzimet mjeksore	3,851	4,637
Mirmbajtja e Softwerit Rikont	142	142
Shpenzimet profesionale	-	1,100
Shpenzimet farmaceutike	-	4,343
Shpenzimet pergaditore sportive,fusha	42,474	-
Shpenzimet e policisë	1,840	1,590
Shpenzimet Transferi I Lojtareve	6,000	6,180
Shpenzimet e mirmbajtjes se fushes	3,827	10,480
Shpenzimet e Pijeve,Ujit	3,470	1,875
Shpenzimet Homologimit	50	50
Shpenzimet e Rexhistrimit Autobusit	170	170
Shpenzimet e Sigurimit Autobusit dhe tjera	1,751	775
Shpenzimet e derivateve	1,713	13,380
Shpenzimet e Reprezentacionit(ushqim)	19,687	14,844
Shpenzimet per lojtar ushqim,banim dhe rruge	55780	-
Shpenzimet e Kafes ne Klub	640	483
Shpenzimet e spitalit	785	-
Shpenzimet e transportit të lojtarve	11,875	-
Shpenzimet e Fitnesit	-	245
Shpenzimet e ndryshme	8,645	-
Shpenzimet e Paisjeve,Mobile,Pc	1,310	-
Shpenzimet e profesionale	-	820
Shpenzimet e programit	650	-
Shpenzimet e bonuseve të lojtarëve	4,930	5,750
Shpenzimet e lojtarëve dhe doktorit	-	12,550
Shpenzimet e banimit	6,000	5,400
Shpenzimet e Arkes Fiskale	-	84
Shpenzimet e Biletave	1,320	294
Shpenzimet e dhuratave	1,776	1,509
Shpenzimet e higjenes	198	177
Shpenzimet e posterave	-	93
Shpenzimet e vetur me qira,Taxi	130	7,680
Shpenzimet Takasa komunale	95	20
Gjithsej	592,885	408,787

		Më 31.12. 2024	Më 31.12. 2023
		EURO	EURO
33. Shpenzimet tjera			
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Edison rexhepi sipas marrveshjes	-	268
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Federaten Shqiptare futb. Licenca	-	425
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Shoqata e trajnerve te kosove leje pune	-	50
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages borgji Adnan Haxhaj sipas marrevshjes	-	1,300
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages rryme banes lojtarit	-	250
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per reklam Gani Ramusholli	-	150
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Kontrolla mjeksore	-	230
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Armend Abazi sips marrveshjes	-	500
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Mirmbajtjes e Rendit	-	200
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages e dresave SOKOL HASANI	-	825
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per ankes ne Federat	-	100
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per karton te kuq Federata	-	50
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages karton i kuq Marko Jovanoski	-	200
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages karton i kuq Veron Berisha dhe Erduan Misi	-	100
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages karton i kuq Enhar Cakolli	-	100
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages Federata e shqiperis Kursi Video-Analysis	-	350
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages karton i kuq Leutrim Rexhepi	-	200
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages KESCO per banim te lotarit	-	520
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages federates per Liridon Fetahaj	-	100
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Participim per kontroll mjekso senior	-	180
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages trusti atk per OJQ	-	2,079
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per OJQ tatim	-	780
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per OJQ tatim	-	767
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages trusti atk per OJQ	-	2,074
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages trusti atk per OJQ	-	2,111
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per OJQ tatim	-	658
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages federate per rexhistrim	-	550
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Shoqat 3 leje te punes	-	240
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per doktorrin Hajdin Lata	-	275
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages veshje Sokoli	-	1,885
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Shoqaten lejen e punes	-	200
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per leje te pune shoqata trajnerve	-	40
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per rekalm Gani Ramusholli	-	200
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per Leje te punes Arsim Abazi Trajner	-	80

Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A. me 31 Dhjetor 2024

Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per referin kadet Abdusamed Leci	-	60
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per referin kadet Imran Murtezi	-	45
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per referin Donat Maliqi	-	45
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pages per referin Besart Llumnica	-	40
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Ndeshkim 07/2023	-	20
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Ndeshkim 07/2023	-	34
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pag.sipas marrveshjes Norik Krasniqi	-	1,700
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pag.sipas marrveshjes Dardan Qerkini	-	706
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pag.sipas marrveshjes Kenan Orana	-	706
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pag.sipas marrveshjes Sokol Kiqina	-	2,000
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura	Pag.sipas marrveshjes Albion Kurtaj	-	3,000
Shpenzimet e Papranushme pa Fatura		25,646	-
Gjithsej		25,646	26,392

34. Shpenzimet financiare

Shpenzimet provizionit

Gjithsej

Më 31.12. 2024

EURO

483

483

Më 31.12. 2023

EURO

475

475

35. Shpenzimet e tatimit në fitim

Fondi i vitit para shpenzimeve tjera

Fitimi për vitin pas shpenzimeve të pa-zbritshme

Shpenzimet e tatimit në fitim

Fondi Neto

Më 31.12. 2024

EURO

(70,274)

(70,274)

-

(70,274)

Më 31.12. 2023

EURO

(39,567)

(39,567)

-

(39,567)

Klubit gjatë vitit 2024 ka afaruar me fond të mbetur Negativë në vlerë prej (70,274) Euro (2023: 39,567) Euro.

36. Detyrimet kontigjente dhe zotimet

Më 31 Dhjetor 2024 nuk ka të paraqitura detyrime kontingjente të cilat kërkojnë shpalosje në pasqyrat financiare të Klubit.

Procedimet gjyqësore

Deri me 31 Dhjetor 2024 ndaj klubit ka të inicuar procedura gjyqësore nga lojtarët në të kaluarën.

37. Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas 31 Dhjetorit 2024 dhe data raportuese deri në miratimin e këtyre raporteve financiare nuk ka ndonjë ngjarje për tu shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të Klubit Futbollistik Ferizaj SH.A.